



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 23.05.2025
Numër Protokolli: 3788/2025

A.nr.549/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtare, me Kaltrina Avdullahi Prenaj-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.546/2025, të 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesi F.S., kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 23.05.2025 mori:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.549/2025, e datës 25.03.2025, e parashtruara nga ankuesi F.S.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.S.(*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 25.03.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Njoftimit të datës 10.03.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 05.05.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1985/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kontratën e punës për kohë të caktuar të datës 06.09.2025; Vendimin KD.nr.09/2024 të datës 27.06.2024; Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023; Njoftimin me Nr.290 të datë 10.03.2025; Formularin e parashtrimit

të ankesës të datës 25.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 05.05.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Përshkrimin e detyrave të punës; Listën e pagave janar 2025 shkurt 2025 dhe mars 2025; Vendimin me numër protokolli 3033/2025 të datës 06.05.2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së pretendimet ankimore janë të pabazuara, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Kontratës së punës të datës 06.09.2018 është i punësuar në pozitën “Mbikëqyrës i Lartë” në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Tuje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me datë 10.03.2025, përmes parashtrës zyrtare me numër protokolli Nr.290, ka njoftuar ankuesin për ekzekutimin e masës disiplinore “*ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy (2) vjet*”. Me arsyetimin së Këshilli më Vendimin A.nr.1049/2024 të datës 10.09.2024, masën disiplinore të shqiptuara sipas vendimit të Komisionit Disiplinor të SHKK-së KD.nr.08/2024 të datës 27.06.2024, *ndalim i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën pesë (5) vjet*, e ka ndryshuar në masën *ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy (2) vjet*.

Ankuesi, kundër njoftimit me numër protokolli Nr.290 të datës 10.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se njoftimi i atakuar me ankesë përmban shkelje esenciale procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Tutje, Kolegji i Këshillit gjatë analizimit të provave të lëndës konstatoi se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, me datë 27.06.2024, përmes Vendimit me numër KD.Nr.08/2024, ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 58 paragrafi 3, nën paragrafi 3.4 dhe 3.12 të Ligjit NR. 08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe nenit 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.4, dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën pesë (5) vjet*”.

Ankuesi kishte kundërshtuar më ankesë Vendimin me numër KD.Nr.08/2024, të datës 27.06.2024 të Komisionit Disiplinor të SHKK-së, ndërsa, Këshilli më Vendimin A.nr.1049/2024 të datës 10.09.2024, ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit në atë mënyrë që masën disiplinore “*ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën pesë (5) vjet*”, e ka ndryshuar më masën disiplinore “*ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy (2) vjet*, andaj, mbi këto rrethana e duke u bazuar në nenin 21 paragrafin 1, dhe nenin 22 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: “1. *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.*” si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 144 paragrafi 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.03/51 për Procedurën

e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.”, Kolegji i Këshillit konstatoi se Njoftimi i datës 10.03.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së, përben veprim procedural në kuptim të ekzekutimit të Vendimit të Komisionit Disiplinor të SHKK-së (i ndryshuar me vendim të Këshillit), i cili është bërë i ekzekutueshëm pas vendimit të Këshillit i marrë sipas ankesës së ankuesit, dhe së pasojat juridike nga ky vendim kanë ndikuar edhe në rritjen e pagës së ankuesit, kështu që, deri sa nuk ekziston një vendim gjyqësor për ndalim të ekzekutimit të vendimit me numër KD.Nr.08/2024, të datës 27.06.2024 të Komisionit Disiplinor të SHKK-së, apo Vendimit A.nr.1049/2024 të datës 10.09.2024, të KPMSHCK-së, atëherë, organi i punësimit ka vepruar në pajtim me dispozita ligjore dhe mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS *A.nr.549/2025*

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.S.;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.